



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 6, DATË 29.01.2020

PËR

**KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË AUTORIZIMIT TË SUBJEKTIT
PERSON FIZIK KRENAR AVDULLA, PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË
PROGRAMIT AUDIOVIZIV MBËSHTETUR NË RRJET KABLLOR "TV
SARANDA KABËLL"**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Subjekti person fizik Krenar Avdulla

Objekt: Konstatimi i pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit personit fizik Krenar Avdulla për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor "Tv Saranda Kabëll".

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 68, geramat "a" dhe "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VËREN SE:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me shkresën përcjellëse nr. 530 prot., datë 30.03.2015, ka autorizuar personin fizik Krenar Avdulla, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Saranda Kabëll". Zona e ofrimit të shërbimit të subjektit është *Njësia Administrative Sarandë*. Afati i vlefshmërisë së autorizimit ka përfunduar në datën 10.12.2019 dhe subjekti nuk ka depozituar aplikim për rinovimin e autorizimit pavarësisht kërkesave të përsëritura të AMA-s.

Konkretisht, AMA, me shkresat nr.3366 prot., datë 18.09.2019 dhe nr. 4449, datë 18.12.2019 ka njoftuar subjektin mbi përfundimin e afatit të vlefshmërisë së autorizimit, duke i kërkuar depozitimin e aplikimit për rinovim.

Subjekti ka depozituar në adresën zyrtare të AMA-s, info@ama.gov.al, kërkesën për heqje dorë nga autorizimi për shkak të vështirësive ekonomike. Në këtë njoftim, subjekti deklaroi që do të shlyejë detyrimet financiare për vitin 2019.

AMA vëren se në zbatim të nenit 58 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”: 3. *Kërkesa konsiderohet në formë të shkruar edhe kur ajo dërgohet me faks ose në rrugë elektronike, me kusht që të tregojë qartë autorin e saj. Ligji mund të kërkojë që kërkesa të nënshkruhet me dorë.*”

Pika 5 e nenit 55 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se: “...Kërkesa për rinovimin e licencës dhe/ose autorizimit bëhet 90 ditë para përfundimit të afatit të licencës ose autorizimit”. Ndërsa neni 68 i ligjit të sipërcituar, parashikon se: “Licenca dhe/ose autorizimi bëhet e pavlefshme kur: a) mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar; b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit; ...”

AMA, gjatë vitit 2019, ka njoftuar subjektin mbi detyrimet financiare duke kërkuar shlyerjen e tyre. Pavarësisht komunikimeve të përsëritura, subjekti vijoi të jetë debitor ndaj AMA-s për vitin 2019, në masën 484,268 lekë, prej të cilave 483,000 lekë për pagesë vjetore për autorizim dhe 1,268 lekë kamatëvonesa për vitin 2018 (njohur si pagesë vjetore për licencë në vitin 2019).

Në zbatim të Vendimit të AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”, ndaj subjektit filloi përlllogaritja e kamatëvonesës prej datës 01.04.2019. Në këto kushte, vlerës së mësipërme të pagesës vjetore për autorizim iu shtua edhe vlera e kamatëvonesës, në masën 132,825 lekë, e llogaritur deri më datë 31 dhjetor 2019.

Duke qenë se nga ana e subjektit nuk u morën masat për shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare, AMA me shkresën nr. 4492 prot., datë 19.12.2019, njoftoi subjektin për procedimin administrativ për konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të tij .

Në vijim, me shkresën nr. 68 prot., datë 09.01.2020, subjektit i është bërë me dije se shqyrtimi administrativ për heqjen e autorizimit të personit fizik Krenar Avdulla, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Tv Saranda Kabëll”, do të bëhej në mbledhjen e radhës së AMA-s.

AMA, në mbledhjen e zhvilluar në datën 16.01.2020, mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së autorizimit të subjektit, për shkak të mosshlyerjes në kohë të detyrimeve financiare ndaj AMA-s. Si përfundim, AMA ra dakord t’i caktojë subjektit datën 29 janar 2020, si afat të fundit për shlyerjen e plotë të detyrimit financiar.

Me shkresën nr. 170 prot., datë 21.01.2020, subjektit i është bërë me dije se shqyrtimi administrativ për heqjen e autorizimit të personit fizik Krenar Avdulla, për subjektin “Tv Saranda Kabëll”, do të bëhet në mbledhjen e radhës së AMA-s.

Subjekti ka kryer më datë 23.01.2019, pagesë në masën 163,000 lekë, prej të cilave për 1,268 lekë për kamatëvonesa të lindura në vitin 2018 dhe 161,372 lekë për pagesë vjetore për autorizim.

Pavarësisht, pagesës së kryer subjekti vijon të jetë debitor ndaj AMA-s në masën 454,093 lekë, prej të cilave 321,268 lekë për pagesë vjetore për autorizim dhe 132,825 lekë kamatëvonesa për vitin 2019.

AMA konstaton se personi fizik Krenar Avdulla, pavarësisht njoftimeve nuk ka depozituar aplikimin përkatës për rinovimin e autorizimit të subjektit kabllor "Tv Saranda Kabëll" si dhe vijon të jetë debitor ndaj AMA-s,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 68, geramat "a" dhe "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Krenar Avdulla, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor "Tv Saranda Kabëll" për shkak të përfundimit të afatit të vlefshmërisë dhe mungesës së interesit nga ana e subjektit.
2. Subjekti person fizik Krenar Avdulla, vijon të jetë debitor ndaj AMA-s për vitin 2019 në masën 454,093 lekë.
3. Subjekti person fizik Krenar Avdulla, me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin ligjor të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 10.12.2019.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA